




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Në bazë të nenit 18.1 dhe nenit 19.2 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149, në përputhje me Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komuna e Fushë-Kosovës shpall:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendit të punës

- I. Titulli i pozitës:** Zyrtar për Ndërtimtari
Lloji i pozitës: I karrierës
Nr. Referencës: RN00005315
Vendi i punës: Komuna e Fushë-Kosovës
Orët e punës: 40h në javë
Koeficienti: 7
Raporton tek: Udhëheqës i Sektorit të Urbanizmit

Qëllimi i postit: Hartimi dhe realizimi i projekteve të përgatitura, në mënyrë që puna të kryhet me sukses dhe në bazë të projektit.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Hartimi i planit të punës, rishikimi i vitit paraprak, evidentimi i sfidave si dhe eliminimi i tyre për vitet në vijim.
2. Hartimi i projekteve ideore sipas kërkesës së udhëheqësit të shërbimit apo shefit të sektorit, pjesë e arkitekturës, hartim dhe punimi i kushtëve ndërtimore, paramasa dhe paralogaria, mbikëqyrja e tyre.
3. Hartimi dhe punimi i lejes ndërtimore, pranimi i kërkesës, llogaritja e taksave komunale, kontrollimi i dokumentacioneve teknik- projekti kryesor.
4. Punimi- lëshimi i lejeve ndërtimore ose refuzimi.
5. Pranimi dhe verifikimi i pëlqimeve që kërkohen në bazë të ligjeve në fuqi.
6. Arkivimi i dokumentacionit të lejuar ose të refuzuar, ruajtja e dosjeve në vende të sigurta, si elektronike po ashtu edhe fizike.
7. Hartimi dhe punimi i njoftimeve mbi destinimin, dërgimi i shkresave në ministrinë përkatëse, pëlqimet.
8. Kryen edhe punë tjera të caktuara, të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme, kohë pas kohe, nga mbikëqyrësi.

Edukimi, eksperiencia, shkathtësitë kyçe:

- Diplomë Universitare – Inxh. i Arkitekturës ose Konstruktiv
- Të ketë së paku 2 vite përvojë pune.
- Njohja e programeve kompjuterike Word, Excel, Autocad, Power Point, Access.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Për arsye të numrit të madh të aplikusve vetëm kandidatët e përzgjedhur për listën e ngushtë do të kontaktohen.

Afati i paraqitjes së dokumentacionit është 15 ditë kalendarike, nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga 31.07.2019 deri më 14.08.2019

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë për aplikim dhe ato të pakompletuara nuk do të pranohen.

Dokumentet e kërkuara –Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten:

- Kopja e letërnjoftimit,
- Diploma e Fakultetit (e noterizuar),
- Dëshmi mbi përvojën e punës,
- Vërtetimi që nuk është nën hetime, si dhe dokumentet tjera të kërkuara sipas kushteve të konkursit.

Kandidatët e interesuar mund t'i marrin aplikacionet çdo ditë pune, nga ora 09:00 deri në ora 15:00, në Zyrën e Arkivit në ndërtesën e Komunës.